



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR, PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 3191 Prot

Tiranë më 20. 10. 2025

Lënda: Përcjellje informacioni mbi mundësinë e aplikimit për bursa në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Teknik Würzburg-Schweinfurt (THWS), Gjermani

Drejtuar: Prof. Dr. Aljula Jubani,
Dejtor i Institutit të Studimeve Europiane

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa mobiliteti për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Teknik Würzburg-Schweinfurt (THWS), Gjermani.

Dokumentacioni duhet dorëzuar i skanuar në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë në adresën e-mail iro@unitir.edu.al.

Afati për aplikim është 05 Nëntor 2025.

Bashkëngjitur gjeni informacione të mëtejshme në lidhje me procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Të përcillet informacioni në strukturat e njësisë suaj, si edhe të publikohet informacioni bashkëngjitur në website-in e njësisë suaj.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

Në mungesë dhe me porosi

ZV/REKTORI

Prof. Dr. Anila Paparisto



**Bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Teknik
Würzburg-Schweinfurt (THWS), Gjermani, në kuadër të programit Erasmus + për semestrin
akademik 2025-2026**

Kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Teknik Würzburg-Schweinfurt, Gjermani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2025-2026.

<https://www.thws.de/>

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;
- PhD;

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Kohëzgjatja e bursave:

- 1 semestër;

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e lëndëve klikoni në adresat:

THWS Business School:

<https://business.thws.de/en/international/incoming/>

Applied Mathematics:

<https://fang.thws.de/mathematik-und-physik/bachelor-applied-mathematics/>

https://fang.thws.de/fileadmin/user_upload/20251011_BAME-Module-Handbook.pdf

Translation:

https://fang.thws.de/fileadmin/user_upload/20240207_BFUE_Modulhandbuch.pdf

Computer Science:

<https://fiw.thws.de/en/international/>

Social Work:

<https://fas.thws.de/en/international/incoming-exchange-students/english-taught-courses/>

Për të gjitha programet e ofruara:

<https://www.thws.de/en/studies-at-thws/studying-at-thws/degree-programmes/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash (për studentët master/PhD duhet të përcillen edhe listat e notave të niveleve të mëparshme të studimit), (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj;
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2025/09/Learning-Agreement-Studente-outgoing.docx>

05 Nëntor 2025

...itet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve
...shtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!